REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 307, Datë 26.10.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI KUSHTET SPECIFIKE PËR NDËRPRERJEN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE TË KLIENTËVE NË NEVOJË"

Në mbështetje të neneve 16, 20, 118 dhe 119 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike";* si dhe të nenit 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3150 prot., datë 22.10.2026, të përgatitur nga Grupi i Punës, të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE nr. 138, datë 18.08.2026, *"Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores "Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë",*

Konstatoi se:

- Neni 118 i ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", parashikon masa për mbrojtjen e klientëve në nevojë, ndërsa neni 119 përcakton rregullat për furnizimin me energji elektrike të kësaj kategorie klientësh. Në veçanti, pika 5 e nenit 119 parashikon zbatimin e kushteve specifike për ndërprerjen e furnizimit, sipas rregullave të miratuara nga ERE, duke përcaktuar kështu bazën ligjore për hartimin dhe miratimin e rregullores përkatëse.
- Aktualisht, kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë rregullohen nga Rregullorja "Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 246, datë 11.12.2018, në mbështetje të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Ky ligj është shfuqizuar me nenin 136, pika 1, të ligjit nr. 59/2026, ndërsa, sipas pikës 2 të këtij neni, aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit të mëparshëm vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin e ri. Për rrjedhojë, është vlerësuar e nevojshme hartimi i një rregulloreje të re, me qëllim përshtatjen e kuadrit rregullator ekzistues me dispozitat e ligjit nr. 59/2026, duke ruajtur mekanizmat e mbrojtjes së klientëve në nevojë që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.
- Me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e akteve për furnizimin dhe mbrojtjen e klientëve", është ngritur Grupi i Punës, i cili, në përmbushje të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, ka hartuar projekt-rregulloren "Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë", në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 59/2026.
- Projekt-rregullorja synon të ruajë dhe të zhvillojë më tej mekanizmat ekzistues të mbrojtjes së klientëve në nevojë, duke përcaktuar kushtet dhe procedurat që duhet të respektohen

përpara, gjatë dhe pas ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike. Në këtë kuadër, projektakti qartëson përgjegjësitë e Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), me qëllim garantimin e një trajtimi të posaçëm dhe jodiskriminues të kësaj kategorie klientësh.

- Projekt-rregullorja përditëson përkufizimet dhe rregullat për regjistrimin dhe çregjistrimin e klientëve në nevojë, duke përcaktuar detyrimet e OSSH-së për administrimin e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit me Furnizuesin e Shërbimit Universal. Gjithashtu, parashikohet që, pas përfundimit të periudhës së trajtimit si klient në nevojë, furnizimi të vijojë sipas kushteve të zakonshme të shërbimit universal, për sa kohë klienti plotëson kushtet për përfitimin e këtij shërbimi.
- Projekt-rregullorja përforcon masat mbrojtëse për klientët në nevojë, duke parashikuar mundësinë e lidhjes së një plani pagese për shlyerjen e detyrimeve të papaguara dhe mosndërprerjen e furnizimit gjatë respektimit të këtij plani. Njëkohësisht, parashikohet mbrojtje e posaçme për klientët në nevojë që përdorin, ose në familjen e të cilëve përdoren, pajisje mjekësore për mbështetjen e jetës, funksionimi i të cilave varet nga furnizimi me energji elektrike, duke përcaktuar mosndërprerjen e furnizimit në rastet kur këto rrethana janë deklaruar dhe dokumentuar pranë Furnizuesit.
- Projekt-rregullorja përcakton në mënyrë më të detajuar procedurën e njoftimit përpara ndërprerjes së furnizimit, duke parashikuar dërgimin e të paktën dy njoftimeve me shkrim dhe dhënien e një afati prej të paktën 7 ditësh kalendarike për shlyerjen e detyrimeve, lidhjen e një plani pagese ose paraqitjen e dokumentacionit që provon ekzistencën e një rrethane që pengon ndërprerjen. Në këtë kuadër, qartësohen detyrimet e Furnizuesit për përmbushjen e procedurave të njoftimit dhe zbatimin e masave mbrojtëse, si dhe përgjegjësia e OSSH-së për kryerjen e ndërprerjes vetëm pas verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe procedurave të zbatueshme.
- Projekt-rregullorja përforcon mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes, duke përcaktuar detyrimin e Furnizuesit dhe OSSH-së për mbajtjen e evidencave të plota dhe të verifikueshme, si dhe për vënien në dispozicion të ERE-s të informacionit dhe dokumentacionit përkatës. Gjithashtu, parashikohen dispozita për trajtimin e ankesave të klientëve në nevojë, duke garantuar të drejtën e tyre për t'iu drejtuar Furnizuesit dhe ERE-s, në përputhje me procedurat përkatëse në fuqi.
- Në kuadër të përshtatjes së kuadrit rregullator me ligjin nr. 59/2026, projekt-rregullorja parashikon rishikimin e disa kushteve dhe kufizimeve të ndërprerjes së furnizimit të përcaktuara në rregulloren ekzistuese, përfshirë ato që lidhen me kushtet atmosferike, nivelin e detyrimeve të papaguara dhe mbrojtjen e klientëve që varen në mënyrë kritike nga furnizimi me energji elektrike. Këto parashikime do t'i nënshtrohen konsultimit publik, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre me kërkesat e ligjit të ri dhe garantimin e mbrojtjes së klientëve në nevojë.
- Për sa më sipër, vlerësohet e nevojshme fillimi i procedurës për miratimin e projekt-rregullores dhe zhvillimi i konsultimit publik me palët e interesuara, përfshirë furnizuesit, operatorët e sistemit dhe organizatat për mbrojtjen e konsumatorëve, me qëllim marrjen dhe shqyrtimin e komenteve dhe propozimeve përpara miratimit përfundimtar të aktit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për miratimin e Rregullores *"Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë"*, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projekt-rregullorja "Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë" t'i nënshtrohet procedurës së konsultimit dhe shqyrtimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës, i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE nr. 138, datë 18.08.2026, për ndjekjen e procedurës, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale lidhur me publikimin, konsultimin dhe administrimin e komenteve mbi projektaktin, si dhe organizimin e seancave dëgjimore, sipas nevojës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 307, Datë 26.10.2026

Projekt-RREGULLORE
MBI KUSHTET SPECIFIKE PËR NDËRPRERJEN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE TË KLIENTËVE NË NEVOJË

Neni 1
Autoriteti

Kjo Rregullore hartohet në mbështetje të:

- nenit 20 dhe neneve 118 dhe 119 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike";
- Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë, të miratuara nga ERE;
- akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë trajtimin dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë.

Neni 2
Objekti

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe procedurat specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për klientët në nevojë, në përputhje me nenet 118 dhe 119 të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe të garantojë mbrojtjen e veçantë të kësaj kategorie klientësh.

Rregullat e përcaktuara në këtë Rregullore zbatohen duke respektuar të drejtat dhe detyrimet e klientëve në nevojë, të Furnizuesit dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Neni 3
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

1. "ERE" është Enti Rregullator i Energjisë.
2. "Klient në nevojë" është klienti familjar, të cilit i është njohur ky status në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
3. "Furnizues" është furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për furnizimin e klientëve në nevojë.
4. "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" ose "OSSH" është operatori përgjegjës për sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 59/2026.
5. "Ndërprerje e furnizimit" është ndërprerja fizike e furnizimit me energji elektrike në pikën e furnizimit të klientit, e realizuar nga OSSH me kërkesë të Furnizuesit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. “Plan pagese” është marrëveshja e dakordësuar ndërmjet klientit në nevojë dhe Furnizuesit për shlyerjen e detyrimeve të papaguara për energjinë elektrike.
7. “Pajisje për mbështetjen e jetës” janë pajisjet mjekësore, funksionimi i të cilave varet nga furnizimi me energji elektrike dhe të cilat përdoren nga klienti ose një pjesëtar i familjes së tij.

Neni 4

Regjistrimi dhe çregjistrimi i klientëve në nevojë

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes krijon dhe administron regjistrin e klientëve në nevojë, bazuar në informacionin dhe të dhënat e administruara sipas legjislacionit në fuqi.
2. OSSH i përcjell Furnizuesit informacionin për klientët e regjistruar si klientë në nevojë, brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 59/2026.
3. Kontrata e furnizimit të klientit në nevojë fillon në ditën e regjistrimit të tij nga OSSH si klient në nevojë. Furnizuesi i paraqet klientit kontratën dhe e informon atë për të drejtat dhe kushtet e furnizimit sipas shërbimit universal.
4. Kur klienti humbet statusin e klientit në nevojë, OSSH e çregjistron atë dhe njofton Furnizuesin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
5. Kontrata e furnizimit të klientit në nevojë përfundon në fund të muajit të dytë nga momenti i çregjistrimit të klientit si klient në nevojë prej OSSH-së.
6. Pas përfundimit të kontratës si klient në nevojë, klienti vijon të furnizohet nga Furnizuesi i shërbimit universal sipas kushteve të zakonshme të furnizimit, pa qenë e nevojshme lidhja e një kontrate të re, për sa kohë plotëson kushtet për përfitimin e shërbimit universal.
7. Të dhënat e klientëve në nevojë administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Detyrimet e Furnizuesit të Shërbimit Universal

Për mbrojtjen e klientëve në nevojë dhe garantimin e furnizimit me energji elektrike, Furnizuesi:

1. Vendos dhe zbaton procedura që sigurojnë se ndërprerja e furnizimit për klientët në nevojë kryhet vetëm në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Nuk ndërpret furnizimin për mospagesë të detyrimeve të energjisë elektrike ndaj klientëve në nevojë të regjistruar, pa përmbushur paraprakisht kushtet dhe masat mbrojtëse të përcaktuara në këtë Rregullore.
3. Nuk ndërpret furnizimin e klientit në nevojë që është në proces të trajtimit të kërkesës për përfitimin e këtij statusi, deri në marrjen e një vendimi për kërkesën, kur ky informacion i është komunikuar Furnizuesit.
4. Nuk ndërpret furnizimin e klientit në nevojë që përdor, ose në familjen e të cilit përdoret, pajisje për mbështetjen e jetës që funksionon me energji elektrike, kur kjo rrethanë i është deklaruar dhe dokumentuar paraprakisht Furnizuesit.

5. Përpara kërkesës për ndërprerjen e furnizimit për mospagesë, i ofron klientit në nevojë mundësinë e lidhjes së një plani pagese(marrëveshje), të përshtatur me mundësitë e tij për shlyerjen e detyrimit.
6. Nuk kërkon ndërprerjen e furnizimit:
   a) gjatë kohës që klienti është duke respektuar një plan pagese të formalizuar me Furnizuesin;
   b) gjatë shqyrtimit të një ankese të klientit lidhur me detyrimin që përbën shkak për ndërprerjen, kur ankesa është paraqitur pranë Furnizuesit ose pranë ERE-s;
   c) në ditët kur Furnizuesi nuk ofron shërbim për klientët në Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit;
   ç) në rastet e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi ose në këtë Rregullore.
7. Për klientët në nevojë të identifikuar si të varur në mënyrë kritike nga energjia elektrike për jetën ose shëndetin e tyre, Furnizuesi zbaton mbrojtjen e posaçme të përcaktuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë Rregullore.
8. Me kërkesë të klientit në nevojë dhe pas shlyerjes së detyrimit që ka shkaktuar ndërprerjen, Furnizuesi merr masat për rilidhjen e furnizimit brenda 48 orëve, sipas kushteve teknike dhe procedurave të zbatueshme.

Neni 6
Rastet e ndërprerjes së furnizimit për klientët në nevojë

Furnizimi me energji elektrike i klientit në nevojë mund të ndërpritet vetëm në rastet e mëposhtme:
1. Kur klienti ka humbur statusin e klientit në nevojë dhe ka përfunduar periudha e përcaktuar në nenin 4, pika 5, të kësaj Rregulloreje.
2. Kur klienti nuk respekton planin e pagesës të dakordësuar me Furnizuesin, pasi është njoftuar sipas procedurës së përcaktuar në këtë Rregullore.
3. Kur klienti ka refuzuar në mënyrë të përsëritur mundësitë e arsyeshme të ofruara nga Furnizuesi për shlyerjen e detyrimeve, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore.
4. Kur klienti nuk përmbush kushtet e një plani pagese të formalizuar dhe nuk ka arritur një marrëveshje tjetër me Furnizuesin.
5. Kur instalimet e brendshme elektrike në pronën e klientit nuk janë në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë në fuqi, në rastet kur kjo përbën shkak të ligjshëm për ndërprerjen e furnizimit.
6. Për shkaqe të forcës madhore ose në raste të tjera të parashikuara shprehimisht në legjislacionin në fuqi.
7. Ndërprerja nuk mund të kryhet në asnjë nga rastet e mbrojtura sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7
Procedura e ndërprerjes së furnizimit nga Furnizuesi

1. Përpara se t'i kërkojë OSSH-së ndërprerjen e furnizimit për një klient në nevojë, Furnizuesi i dërgon klientit të paktën dy njoftime me shkrim.

2. Njoftimi i parë përmban paralajmërimin për ndërprerjen dhe i jep klientit një afat prej të paktën 7 ditësh kalendarike për të shlyer detyrimin, për të lidhur një plan pagese ose për të paraqitur dokumentacionin që provon ekzistencën e një rrethane që pengon ndërprerjen.
3. Njoftimi i dytë përmban njoftimin përfundimtar për ndërprerjen dhe dërgohet vetëm pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e parë.
4. Njoftimi i parë duhet të përmbajë të paktën:
   a) arsyen e ndërprerjes;
   b) shumën e detyrimit që përbën shkak për ndërprerjen;
   c) datën e përfundimit të afatit të paralajmërimit;
   ç) mënyrën dhe afatin për kryerjen e pagesës;
   d) mundësinë për lidhjen e një plani pagese;
   dh) mënyrën e paraqitjes së ankesës pranë Furnizuesit;
   e) të drejtën e klientit për t'iu drejtuar ERE-s, sipas legjislacionit në fuqi;
   ë) informacionin dhe të dhënat e kontaktit të Furnizuesit dhe OSSH-së.
5. Pas dërgimit të njoftimit të parë, Furnizuesi merr masa të arsyeshme për të kontaktuar klientin në nevojë dhe për t'i dhënë mundësinë të shlyejë detyrimin ose të lidhë një plan pagese.
6. Furnizuesi nuk mund t'i kërkojë OSSH-së ndërprerjen e furnizimit përpara përfundimit të procedurës së përcaktuar në këtë nen.
7. Kërkesa për ndërprerje i dërgohet OSSH-së në formën dhe mënyrën e përcaktuar ndërmjet Furnizuesit dhe OSSH-së dhe duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për identifikimin e klientit dhe të pikës së furnizimit.
8. OSSH kryen ndërprerjen vetëm pas verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe procedurës së përcaktuar në këtë Rregullore dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 8
Monitorimi dhe mbikëqyrja

1. ERE, në zbatim të kompetencave të saj, monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kësaj Rregulloreje nga Furnizuesi dhe OSSH-ja.
2. Furnizuesi dhe OSSH-ja janë të detyruar t'i vënë ERE-s në dispozicion, sipas kërkesës, të dhënat dhe dokumentacionin që lidhet me regjistrimin, çregjistrimin, njoftimin, ndërprerjen dhe rilidhjen e klientëve në nevojë.
3. Furnizuesi dhe OSSH-ja mbajnë evidenca të plota dhe të verifikueshme për veprimet e kryera në zbatim të kësaj Rregulloreje.
4. Shkeljet e kësaj Rregulloreje i nënshtrohen masave të parashikuara në ligjin nr. 59/2026 dhe aktet rregullatore në fuqi.

Neni 9
Ankimimi

1. Klienti në nevojë, përpara se t'i drejtohet ERE-s, paraqet ankesën pranë Furnizuesit, përveç rasteve kur legjislacioni parashikon ndryshe.
2. Klienti ka të drejtë të paraqesë ankesë në ERE lidhur me mosrespektimin e kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore, në përputhje me rregullat dhe afatet për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fuqi.
3. Paraqitja e ankesës nuk pezullon automatikisht procedurën e ndërprerjes, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi ose kur ERE vendos pezullimin e saj.

Neni 10
Amendimi

Kjo Rregullore është objekt ndryshimi me Vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE-s dhe publikimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.